

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

NELSA

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J71601012S

NUIS/NIPT

Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692111105

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

shpknela@gmail.com

E-mail

Administrator Elsa Kamberi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/06/12

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355692111105

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-71460-06-05-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.*

Bashkia Kavaje

---

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

11890039

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Furnizimi me ushqime për kopshte, çerdhe dhe konviktorë

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/06/21

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/06/21

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/36378/06052023

03211300-6 , 03220000-9 , 15131600-1 , 156

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

LIGJI NR. 162 DATE 23.12.2020 PER PROKURIMIN PUBLIK

VENDIM NR. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, i ndryshuar

Rekomandim” Nr.6732 Prot, datë 21.10.2020 , “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime” nga ”Agjencia e Prokurimit Publik”

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër □

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Në datën 06.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me objekt “Furnizimi me ushqime per kopshte, çerdhe dhe konviktorë” me REF-71460-06-05-2023 me fond limit 11,890,039.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar më datë 21.06.2023 nga autoriteti kontraktor “Bashkia Kavajë”.

Shoqëria jonë shfaqet në cilësinë e shoqërisë të interesuar në furnizimin me mallrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë kemi interes të drejtpërdrejtë për të marrë pjesë në procedurën e mësipërme të prokurimit. Pasi shqyrtuam dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta të kualifikimit, specifikimet teknike të procedurës, gjykojmë se këto të fundit nuk janë hartuar në përputhje me ligjin “Për prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij duke rënë ndesh me kuadrin ligjor në fuqi, duke ulur gjithëpërfshirjen e operatorëve ekonomikë dhe për rrjedhojë duke zvogëluar konkurrencën dhe efikasitetin e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, paraqesim ankesën si më poshtë vijon:

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

#### **I. MBI LEGJITIMITETIN**

Në nenin 110 pika 1, paragrafi 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. -Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Në nenin 94 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedure prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

3. Ankimesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar. Ankimesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimesi duhet t’i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.”

Sa më sipër, në cilësinë e shoqërisë së interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit,

interesi i së cilës rrezikon të dëmtohet për shkak të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij shoqëria jonë gëzon legjitimitet të drejtëpërdrejtë dhe aktiv për të paraqitur ankesë në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”, ankesa është paraqitur njëkohësisht në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në zbatim të rregullave të parashikuara në ligjin 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe brenda afatit 7 ditor nga data e publikimit të procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike duke u legjitimuar.

Pasi morëm në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta për kualifikim, specifikimet teknike si dhe formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatojmë se nga ana e autoritetit kontraktor janë kryer shkelje në drejtim të hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit duke rënë ndesh me ligjin 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, duke rënë ndesh me parimet dhe qëllimet e kuadrit ligjor në fuqi.

Së pari, në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se: “2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.”

Në nenin 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me

dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 4 e Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim në varësi të volumit si dhe të natyrës së kontratës, me qëllimin e krijimit të një panorame sa më të qartë për kapacitetet teknike

dhe profesionale që zotërojnë operatorët ekonomik në mënyrë të tillë që të provojnë dhe të garantohen se këto të fundit zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Megjithatë, pavarësisht qëllimit kryesor të autoritetit kontraktor që të provojë dhe të garantohet se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, vlerësojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesa proporcionale në varësi të volumit si dhe të natyrës së kontratës duke u bazuar në një analizë të detajuar në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën dhe të maksimizojë efikasitetin e procedurës së prokurimit.

Në rastin konkret pasi morëm në shqyrtim dokumentat standarte të tenderit vlerësojmë se kërkesa që operatorët ekonomikë “në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, është një kërkesë e ekzagjeruar e cila bie në kundërshtim me ligjin “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe për këtë arsye nuk qëndron.

Në lidhje me sa më sipër kërkojmë të sqarojmë se autoriteti kontraktor harton kriteret e kualifikimit në varësi të natyrës dhe volumit të procedurës së prokurimit, me qëllim për të maksimizuar efikasitetin dhe konkurrencën e procedurës së prokurimit dhe në të njëjtën kohë për të krijuar një panoramë më të qartë për kapacitetet ekonomike-financiare, teknike dhe profesionale që zotërojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të krijojë bindje dhe garanci mbi kapacitetet e operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës.

Në rastin konkret vlerësojmë se autoriteti kontraktor mund të garantohet që operatorët zotërojnë përvojën e duhur për realizimin e kontratës edhe nëse në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të dorëzojnë kontratën të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës OSE faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, pra pa qënë e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë të dy këto dokumente për vërtetimin e përvojës së mëparshme.

Gjykojmë se kërkesa që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vërtetuar që zotërojnë përvojën e duhur për realizimin e kontratës në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik të dorëzojnë vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes është një kërkesë e dublikuar e cila vërteton të njëjtin fakt dhe nuk i shërben qëllimit final të parashikuar në legjislationin në fuqi.

Gjithashtu, bazuar në ligjin “Për Prokurimin Publik” dhe aktet ligjore në zbatim të tij si dhe në frymën e legjislationit në fuqi konsatojmë se jo vetëm që lihet e hapur mundësia për të kërkuar vetëm njërin prej 2 dëshmimeve (kontratë shoqëruar me vërtetim realizimi ose fature tatimore shitje) por akoma më tej fryma e legjislationit në fuqi është që të mos ketë kriteret e dublikuara dhe të ekzagjeruara që dëmtojnë konkurrencën dhe efikasitetin e procedurës së prokurimit por përkundrazi autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesa proporcionale në varësi të volumit si dhe të natyrës së kontratës duke u bazuar në një analizë të detajuar në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën dhe të maksimizojë efikasitetin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me sa më sipër, kërkojmë modifikimin e kriterit të mësipërm.

Së dyti, në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se: “2.3.2. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Konkretisht:

1. Për produktet e mishit (mish vici, mish pule, fileto pule, kremvice etj.) të paraqitet certifikatë UNI 10854

- Standard i Sistemeve të Vetëkontrollit Higjenik bazuar në metodën HACCP / ekuivalente dhe e vlefshme dhe ISO 22000 (Standard për Sistemet e Menaxhimit për Sigurinë e Ushqimit) / ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë

prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin dhe certifikata përkatëse e prodhuesit.

2. Për produktet me bazë qumështi (qumësht, kos, djath I bardhë, djath kackavall etj.) të paraqitet certifikatë

ISO 22000 (Standard për Sistemet e Menaxhimit për Sigurinë e Ushqimit) / ekuivalente dhe e vlefshme.

Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin dhe certifikata përkatëse e prodhuesit.

Produktet me bazë qumështi, gjatë dorëzimit të tyre pranë Autoritetit Kontraktor, duhet të shoqërohen gjithmonë me certifikatën përkatëse të analizës baktoreologjike.

3. Për produktet bimore fruta - perime (mollë, portokall, domate, kunguj, kastravec, brokoli, qepë, hudhër

etj.) të paraqitet certifikatë Global G.A.P. - Standard i praktikave të mira bujqësore) / ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin dhe certifikata përkatëse e prodhuesit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.”

Në nenin 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,

parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 79 “ Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

”1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efijencës së energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

Në nenin 40 pika 5 e Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkats; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

Në nenin 44 ”Kërkesat e cilësisë” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: ”1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në

mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-së.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.”

Në interpretim literal dhe sistematik të të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim në varësi të volumit si dhe të natyrës së kontratës, me qëllimin e krijimit të një panorame sa më të qartë për kapacitetet teknike dhe profesionale që zotërojnë operatorët ekonomik në mënyrë të tillë që të provojnë dhe të garantohen se këto të fundit zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Megjithatë, pavarësisht qëllimit kryesor të autoritetit kontraktor që të provojë dhe të garantohet se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, vlerësojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesa proporcionale në varësi të volumit si dhe të natyrës së kontratës duke u bazuar në një analizë të detajuar në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën dhe të maksimizojë eficientësinë e procedurës së prokurimit.

Në rastin konkret konstatojmë se më anë të kërkesës së mësipërme autoriteti kontraktor ka kërkuar në total disponimin e tre certifikimeve të ndryshme dhe më specifikisht “Për produktet e mishit certifikatë UNI 10854-HACCP/ekuivalente dhe ISO 22000.” ; “Për produktet me bazë qumështi”: certifikatë ISO 22000/ekuivalent ; “Për produktet bimore fruta – perime”: certifikatë Global G.A.P. - Standard i praktikave të mira bujqësore/ekuivalente” , me kushtin që “Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin dhe certifikata përkatëse e prodhuesit.”

Në lidhje me kërkesën e mësipërme vlerësojmë se është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo

proporcionale e cila bie ndesh me parimin e mosdiskriminimit duke sjellë si pasojë uljen e kokurencës si dhe të efijencës së procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në lidhje me sa më sipër kërkojmë të sqarojmë se operatorët ekonomikë ofertues në një procedurë mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallrave objekt prokurimi, por e sigurojnë mallin nga prodhuesit apo nga distributorët e tyre dhe më pas e tregëtojnë këtë mall në varësi të liçencave që disponojnë. Në këtë rast pasi morëm në shqyrtim kërkesën e mësipërme konsatojmë se kërkesa për paraqitjen e çertifikatave UNI 10854-HACCP/ekuivalente , ISO 22000/ekuivalente, dhe çertifikatës Global G.A.P. - Standard i praktikave të mira bujqësore/ekuivalente”, i adresohet palëve të treta (prodhuesit/distributorit) të cilët nuk janë konkurrent/kandidat në procedurën e prokurimit. Vlerësojmë se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumentave të tenderit duhet të kërkojë vetëm dokumente që vërtetojnë gjëndjen e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe është e ekzagjeruar kërkesa për disponueshmërinë çertifikimeve të ndryshme të palëve të treta (prodhuesve/distributorëve) të cilët nuk janë pjesë e procedurës së prokurimit.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe “Agjencia e Prokurimit Publik” në Rekomandimin Nr.6732 Prot, datë 21.10.2020 ,“Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku ndër të tjera në rekomandimet që i jep autoriteteve kontraktore përsa i përket hartimit të dokumentave të tenderit përsa i përket kërkesave për disponueshmërinë e çertifikimeve ISO “Agjencia e Prokurimit Publik” shprehet se: [?Rekomandojmë që autoritetet kontraktore të shmangin kërkesa të tilla për dokumente që u drejtohen palëve të treta që nuk janë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, dhe për të garantuar cilësinë, të përcaktojnë te specifikimet teknike karakteristikat dhe kërkesat që mallrat duhet të plotesojnë?]

Në lidhje me sa më sipër, kërkojmë modifikimin e kriterit të mësipërm pasi vlerësojmë se është një kriter i ekzagjeruar, diskriminues dhe jo proporcional dhe gjykojmë se për të garantuar autoritetin kontraktor mbi realizimin me sukses të kontratës në cilësi dhe sasi është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë në rast se nuk janë prodhues të mallrave objekt prokurimi të disponojnë një marrëveshje/kontratë furnizimi me prodhuesit e këtyre mallrave, POR pa qënë e nevojshme të kërkohet dorëzimi i çertifikimeve të mësipërme të prodhuesve të cilët ritheksojmë se janë palë të treta që nuk janë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Sa më sipër kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës ;
2. Pezullimin e procedurës së prokurimit ;
3. Modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit ;

## 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)*

---

## 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk kemi asnjë kërkesë

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

N/A

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

shpknela@gmail.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Elsa Kamberi